

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Bazat e Auditimit të
Brendshëm
Internal Audit Basics**

B2

Nr.

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT

Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË
KËTIJ PROVIMI.

Your name should appear nowhere in this test.

Data 06.10.2018

CONTENT / PËRMBAITJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Total	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Cila nga të mëposhtmet shton vlerë për të tjerët?
 - A. Proceset e qeverisjes.
 - B. Proceset e menaxhimit të rrezikut.
 - C. Aktivitetet e auditimit të brendshëm.
 - D. Proceset e kontrollit.
2. Cila nga të mëposhtmet përshkruan natyrën e auditimit të brendshëm?
 - A. Standardet e Veçorive të Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA).
 - B. Standardet e Performancës të Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA).
 - C. Standardet e Implementimit të Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA).
 - D. Standardet e palëve të treta.
3. Cila nga të mëposhtmet nuk është e përfshirë në vlerësimin e vazhdueshëm dhe periodik që përmban matjet dhe analizat e metrikave të performancës në lidhje me programin e sigurisë dhe përmirësimit të cilësisë së auditimit të brendshëm?
 - A. Paratë e kursyera nga puna e auditimit.
 - B. Numri i rekomandimeve të pranuar.
 - C. Kënaqësia e konsumatorëve.
 - D. Koha e ciklit të auditimit.
4. Nëse rezultatet e vlerësimit të programit të sigurisë dhe përmirësimit të cilësisë së auditimit të brendshëm tregojnë fushat për përmirësim, cili nga të mëposhtmit do të implementojë përmirësimet e tilla?
 - A. Komiteti i auditimit.
 - B. Shefi ekzekutiv i auditimit.
 - C. Drejtori Ekzekutiv.
 - D. Auditori i jashtëm.
5. Cila nga këto është e përbashkët ndërmjet vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm të një aktiviteti të auditimit të brendshëm?
 - A. Standardet e Auditimit.
 - B. Statuti i auditimit.
 - C. Kodi i Etikes.
 - D. Përkufizimi i auditimit të brendshëm.
6. Kur një organizatë është e përfshirë në një varg riparimitesh financiare dhe hetime rregullative, kjo do të ndikonte negativisht cilën nga të mëposhtmet?
 - A. Biznesi rrezikohet.
 - B. Dështimet e auditimit.
 - C. Sigurinë e rrejtshme të auditimit.
 - D. Reputacioni i auditimit rrezikohet.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Mrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

7. Programi i sigurimit të cilësisë i departamentit të auditimit të brendshëm ofron siguri të arsyeshme që puna e auditimit përputhet me standardet e aplikueshme. Cilat nga aktivitetet e mëposhtme është e dizajnuar për të ofruar reagim (feedback) lidhur me efektivitetin e departamentit të auditimit?
- I. Mbikëqyrja e duhur.
 - II. Trajnimi i duhur.
 - III. Rishikimet e brendshme.
 - IV. Rishikimet e jashtme.
- A. I, II, dhe III.
B. II, III, dhe IV.
C. I, III, dhe IV.
D. I, II, III, dhe IV.
8. Drejtori i auditimit të brendshëm të një organizate të mesme të auditimit të brendshëm ishte i shqetësuar se menaxhmenti mund të kontraktojë funksionin e auditimit të brendshëm. Prandaj, menaxheri adoptoi një program shumë agresiv për të promovuar departamentin e auditimit të brendshëm brenda organizatës. Menaxheri planifikonte t'i paraqiste rezultatet tek menaxhmenti dhe komiteti i auditimit dhe të rekomandonte modifikimin e statutit të auditimit të brendshëm pas përdorimit të programit të ri. Në vijim janë paraqitur gjashtë veprime që menaxheri i auditimit i ndërmori për të promovuar një imazh pozitiv brenda organizatës.
- I. Angazhimet e auditimit u koncentruan në auditimet e ekonomisë dhe efikasitetit. Auditimet u përqëndruan vetëm në kursimet e kostos dhe secili raport i auditimit theksoi kostot e mundshme që mund të kursehen. Gjetjet negative u lanë jashtë. Fokusi në auditimin e ekonomisë dhe efikasitetit ishte i ri, por të audituarit dukeshin shumë të lumtur.
 - II. Draftet e të gjitha raporteve të auditimit u rishikuan me kujdes me të audituarit për të marrë kontributin e tyre. Komentet e tyre u konsideruan me kujdes gjatë zhvillimit të raportit përfundimtar të auditimit.
 - III. Auditori i TI-së ishte pjesë e ekipit të zhvillimit për të shqyrtuar procedurat e kontrollit që do të inkorporoheshin në një aplikacion të madh kompjuterik në zhvillim.
 - IV. Duke pasur parasysh burimet e kufizuara, menaxheri i auditimit ka kryer një analizë të rrezikut për të përcaktuar se cilat vende duhet të auditohen. Kjo ishte një largim i dukshëm nga qasja e mëparshme që siguronte që të gjitha operacionet do të rishikohen për të paktën një interval trevjeçar.
 - V. Për të kursyer kohë, menaxherët nuk kërkonin më një pyetësor të standardeve të kontrollit të brendshëm për çdo auditim.
 - VI. Kur auditorët gjetën se menaxhmenti dhe i audituari nuk kishin zhvilluar kritere ose të dhëna specifike për të vlerësuar operacionet e të audituarit, ekipi i auditimit u udhëzua për të kryer kërkime, për të zhvilluar kritere specifike, për të rishikuar kriteret me të audituarin dhe nëse është e pranueshme, për të vlerësuar operacionet e të audituarit. Nëse i audituari nuk pajtohet me kriteret, zhvilloheshin negociata derisa të pajtoheshin lidhur me kriteret e pranueshme. Raporti i auditimit komentonte për operacionet e të audituarit në lidhje me kriteret e rëna dakord.

Sa i përket veprimit të 6-të, cili nga elementet e mëposhtme të veprimit do të konsiderohet shkelje e Standardeve të Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA)?

- A. Dështimi për të raportuar mungesën e kriterëve tek niveli i duhur i menaxhimit.
- B. Zhvillimi i një sërë kriteresh për t'ia paraqitur të audituarit si bazë për vlerësimin e operacioneve të të audituarit.
- C. Komentimi sipas kriterëve të rëna dakord.
- D. Të gjitha të mësipërmet.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Mrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

9. Interpretimi i sigurimit të cilësisë të dhënë nga Standardet e IIA është që:
- A. Rishikimet e sigurimit të cilësisë mund t'i sigurojnë menaxhmentit të lartë dhe komitetit të auditimit një vlerësim të funksionit të auditimit të brendshëm.
 - B. Aktiviteti ndjekës (follow-up) i duhur për një rishikim të jashtëm është përgjegjësi e mbikëqyrësit të menjëhershëm të shefit ekzekutiv të auditimit.
 - C. Departamenti i auditimit të brendshëm kryesisht matet kundrejt Kodit të Etikës të IIA.
 - D. Mbikëqyrja e vazhdueshme është e kufizuar në planifikimin, ekzaminimin, raportin e vlerësimit dhe procesin e aktivitetit ndjekës (follow-up).
10. Juve ju është kërkuar që të jeni anëtar i një ekipi rishikues të kolegëve (peer review). Gjatë vlerësimit të pavarësisë së departamentit të auditimit të brendshëm që po rishikohet, ju duhet t'i konsideroni të gjithë faktorët e mëposhtëm, përveç:
- A. Qasjes dhe frekuencës së komunikimit me bordin e drejtorëve ose komitetin e tij të auditimit.
 - B. Kriteve të arsimit dhe të përvojës që konsiderohen të nevojshme kur mbushen pozitat e lira në stafin e auditimit.
 - C. Shkallës në të cilën auditorët marrin përgjegjësitë operative.
 - D. Qëllimit dhe thellësisë së objektivave të auditimit për auditimet e përfshira në rishikim.
11. Objektiviteti i auditorit mund të rrezikohet në të gjitha situatat e mëposhtme, përveç:
- A. Në një konflikt interesi.
 - B. Në familjarizimin e të audituarit me auditorin për shkak të mungesës së rotacionit në angazhime.
 - C. Supozimeve të detyrave operacionale nga auditori në baza të përkohshme.
 - D. Mbështetjes në opinionin e një eksperti të jashtëm kur është e përshtatshme.
12. Sipas standardeve të IIA, shefi ekzekutiv i auditimit duhet të përcaktojë qëllimet që kanë dy cilësi themelore. Zgjidhni tiparet e sakta të objektivave të auditimit të brendshëm:
- A. Të matshme dhe të arritshme.
 - B. Të buxhetuara dhe miratuara.
 - C. Të planifikuara dhe të arritshme.
 - D. Të kërkuara dhe të miratuara.
13. Nëse një auditor i brendshëm konstaton se nuk është ndërmarrë asnjë veprim korrigjues për një gjetje të mëparshme të auditimit dhe që është akoma valide, Standardet e IIA potencojnë se auditori i brendshëm duhet të:
- A. Rivendos gjetjet e mëparshme së bashku me gjetjet e auditimit aktual.
 - B. Përcaktoj nëse menaxhmenti apo bordi ka marrë përsipër rrezikun e mos ndërmarrjes së veprimeve korrigjuese.
 - C. Kërkoj miratimin e bordit për të ndërmarrë veprime korrigjuese.
 - D. Planifikoj një auditim të ardhshëm të fushës specifike.
14. Cila nga metodat e mëposhtme është më e përshtatshme për raportimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet auditorit dhe të audituarit në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit?
- A. Raportoni qëndrimin e auditorit sepse raporti është dizajnuar për të siguruar shikimin e pavarur të auditorit.
 - B. Raportoni qëndrimin e të audituarit sepse menaxhmenti përfundimisht është përgjegjës për aktivitetet e raportuara.
 - C. Raportoni qëndrimet e të dyja palëve dhe identifikoni arsyet e mosmarrëveshjes.
 - D. Mos raportoni asnjërin qëndrim. Nëse mosmarrëveshja përfundimisht zgjidhet, nuk do të ketë arsye për të raportuar mosmarrëveshjen e mëparshme. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet kurrë, mosmarrëveshja nuk duhet të raportohet, sepse nuk ka mekanizma për ta zgjidhur atë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

15. Menaxhmenti pohoi se standardet e performancës që auditorët përdorën për të vlerësuar performancën operative ishin të papërshtatshme. Standardet e shkruara të performancës që ishin krijuar nga menaxhmenti ishin të paqarta dhe duhej të interpretoheshin nga auditori. Në raste të tilla, auditorët mund të përmbushin përgjegjësinë e tyre të kujdesit të duhur profesional:
- A. Duke u siguruar që interpretimet e tyre janë të arsyeshme.
 - B. Duke u siguruar që interpretimet e tyre janë në përputhje me praktikat e industrisë.
 - C. Duke krijuar marrëveshje me të audituarin për standardet e nevojshme për të matur performancën.
 - D. Duke përfshirë kundërshtimet e menaxhmentit në raportin e auditimit.
16. Kodi i Etikës i Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA) përfshin cilën nga dy komponentët kryesore të paraqitura në vijim?
- A. Përkufizimet e auditimit të brendshëm dhe direktivat administrative.
 - B. Parimet dhe rregullat e sjelljes.
 - C. Integritetin dhe objektivitetin.
 - D. Konfidencialitetin dhe kompetencën.
17. Një Auditor i Brendshëm i Çertifikuar (CIA), i cili është duke u gjykuar nga bordi i drejtorëve i Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA) pasi që është në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Etikës të IIA-së, do të jetë subjekt i:
- A. Pezullimi i thirrjes Auditor i Brendshëm i Çertifikuar (CIA) për një vit më e pakta.
 - B. Përfundimi i orëve shtesë të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (CPD) për të mbajtur thirrjen Auditor i Brendshëm i Çertifikuar (CIA).
 - C. Pezullimin e thirrjes Auditor i Brendshëm i Çertifikuar (CIA) për një kohë të pacaktuar deri në rivendosjen e bordit.
 - D. Konfiskimi të thirrjes Auditor i Brendshëm i Çertifikuar (CIA).
18. Një auditor zbulon një mungesë të materialit në një funksion blerjeje. Menaxheri i blerjes është fqinji i afërt i auditorit dhe shoku më i mirë i tij. Në përputhje me Kodin e Etikës, auditori duhet:
- A. Të përfshijë faktet e rastit në mënyrë objektive në raportin e auditimit.
 - B. Të mos e raportoj incidentin për shkak të besnikërisë ndaj mikut.
 - C. Të përfshij faktet e rastit në një raport të veçantë të paraqitur vetëm tek shoku i tij.
 - D. Të mos e raportoj shokun nëse aktiviteti nuk është i paligjshëm.
19. Gjatë një auditimi, një auditor zbulon se një nëpunës po përvetëson fondet e kompanisë. Edhe pse ky është përvetësimi i parë që haset ndonjëherë dhe organizata ka një departament të sigurisë, auditori vendos që personalisht të marrë në pyetje të dyshuarin. Nëse auditori është duke shkelur Kodin e Etikës të IIA, rregulli i shkelur ka më shumë gjasa:
- A. Të jetë dështim për të treguar kujdesin e duhur.
 - B. Të jetë mungesë e besnikërisë ndaj organizatës.
 - C. Të jetë mungesë e kompetencës në këtë fushë.
 - D. Të jetë mosrespektim i ligjit.

20. Standardet e auditimit theksojnë që auditori i brendshëm mund të komunikojë rekomandimet për përmirësime. Cila nga të mëposhtmet do të ishte një justifikim i vlefshëm për mosdhënien e rekomandimeve në një raport të auditimit? Auditori:
- A. Mund të mos kuptojë gjithmonë shkaqet e vërteta të gjetjeve të raportuara.
 - B. Nuk ka kohë të mjaftueshme për të formuluar një rekomandim për shkak të presioneve të buxhetit të auditimit.
 - C. Mund të shmangë konfrontimin duke i lejuar menaxhmentit të zgjidhë problemet e veta.
 - D. Mund të humbasë pavarësinë duke u perceptuar si marrës i vendimeve operacionale.
21. Si pjesë e një programi të përgjithshëm të kontrollit të cilësisë, një firmë jo vetëm që inspekton mallrat e përfunduar dhe të gatshëm për shitje, por monitoron edhe produktet që kthehen dhe ankesat e konsumatorëve. Cili lloj i kontrolleve i përshkruan më së miri këto përpjekje?
- A. Kontrollat reaguese (feedback).
 - B. Kontrollat parandaluese.
 - C. Kontrollat e prodhimit.
 - D. Kontrollat e stoqeve.
22. Një lloj i veçantë i kontrollit shpesh kritikohet sepse veprimi korrigjues bëhet pas faktit. Çfarë lloji i kontrollit e ekspozon këtë tipar?
- A. Kontrollat automatik.
 - B. Kontrollat reaguese (feedback).
 - C. Kontrollat strategjike.
 - D. Kontrollat e avancuara.
23. Cila nga kontrollet e të dhënave hyrëse (input controls) ose kontrolleve të modifikimit do të zbulonte lloje të caktuara të gabimeve brenda fushës së shumës së pagesës së një transaksioni:
- A. Numërimi i regjistrimeve.
 - B. Kontrolli echo.
 - C. Kontrollimi i shifrës.
 - D. Kontrollimi i limitit.
24. Koncepti i kontrollit duhet të shihet si:
- A. Përbushje e një objektive.
 - B. Kufizim i një operacioni.
 - C. Bllokim i një procesi.
 - D. Frenim i një personi.
25. Cili grup ka përgjegjësinë kryesore për krijimin, implementimin dhe monitorimin e kontrolleve adekuate gjatë regjistrimit të llogarive të arkëtueshme?
- A. Auditorët e jashtëm.
 - B. Stafi i llogarive të arkëtueshme.
 - C. Auditorët e brendshëm.
 - D. Menaxheri i kontabilitetit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

26. Sipas Standardeve të IIA, cila nga të mëposhtmet përshkruan më së miri dy kategoritë e përgjithshme ose llojet e mashtrimeve që kanë të bëjnë me auditorët e brendshëm?

- A. Pagesat e pahijshme (dmth. mitot dhe ryshfetet) dhe mashtrimet tatimore.
- B. Mashtrimi i projektuar për të përfituar organizata dhe mashtrimi i kryer në dëm të organizatës.
- C. Pranimi i mitove ose ryshfeteve dhe kryerja e transaksioneve të paligjshme me palët e ndërlidhura.
- D. Pranimi i shantazheve ose përvetësimi dhe keqpërdorimi i pasurisë.

27. Përdorimi mashtrues i kartelave të kreditit të korporatave do të minimizohej me cilin nga procedurat e mëposhtme të kontrollit të brendshëm?

- A. Krijimi i një politike korporative për lëshimin e kartave të kreditit për punonjësit e autorizuar.
- B. Rishikimi i vlefshmërisë së kartës së kreditit në nivel ekzekutiv dhe operues në baza periodike.
- C. Harmonizimi i gjendjes mujore të kredit kartës së korporatës me kopjet e dorëzuara të faturave të ngarkuara ndaj mbajtësit të kredit kartës.
- D. Subjektimi i tarifave të kartës së kreditit ndaj të njëjtave kontrole të shpenzimeve si ato të përdorura në formën e shpenzimeve të rregullta të kompanisë.

28. Menaxhmenti i Bankës dyshon se një zyrtar për kredi i bankës shpesh ka dhënë hua për kompanitë fiktive, ka arkëtuar shumat e kredisë në llogarinë personale dhe duke lënë kështu kreditë si të papaguara në kohë. Disa fakte përkatëse në lidhje me zyrtarin për kredi përfshijnë:

- Një standard i lartë jetese, i shpjeguar si rezultat i investimeve të shëndosha dhe mos marrjes së pushimeve.
- Një makinë e shtrenjtë personale e fituar nëpërmjet kontakteve të biznesit.
- Faturat e benzinës dhe të riparimit të dorëzuara nga kompania e makinave e përcaktuar nga banka, që janë më të larta se mesatarja e kompanisë (shkrimet e kilometrave janë dorëzuar në baza tremujore).
- -Bezdi e dukshme lidhur me pyetjet nga auditorët.

Analiza e trendit, më e përshtatshme për të treguar këtë mashtrim të mundshëm është:

- A. Normat e kredive të papaguara të lëshuara nga ky zyrtar i kredive.
- B. Akumulimi i ditëve të papaguara të pushimeve.
- C. Shpenzimet operative të automjetit të bëra nga ky zyrtar i kredive.
- D. Vëllimi total i dollarit të kredive të lëshuara nga ky zyrtar i kredive.

29. Në mënyrë që auditorët e brendshëm të jenë në gjendje të njohin mashtrimin e mundshëm, ata duhet të jenë të vetëdijshëm për karakteristikat themelore të mashtrimit. Cila nga të mëposhtmet nuk është një karakteristikë e mashtrimit?

- A. Mashtrimi i qëllimshëm.
- B. Marrja e përfitimit të padrejtë ose të pandershëm.
- C. Kryerja e verprimit në dobi ose në dëm të organizatës.
- D. Neglizhenca nga ana e menaxhmentit ekzekutiv.

30. Një auditor po heton performancën e një divizioni me një rritje të pazakontë të shitjeve, marzhës bruto dhe fitimit. Nëse auditori vazhdon të dyshojë në regjistrimin mashtrues të transaksioneve për të rritur fitimet e raportuara, cili nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të jetë më pak efektive?

- A. Marrja e stoqeve fizike.
- B. Zhvillimi i një plani mujor të stoqeve dhe hetimi i luhatjeve të pazakonta duke iu referuar regjistrimeve të përhershme të stoqeve.
- C. Përgatitja e një plani mujor të luhatjeve të shitjeve dhe marzhës brutoj. Hetoni muajt me shitje dhe marzhë bruto jashtëzakonisht të lartë nëpërmjet shqyrtimit të mbështetjes për shitjet.
- D. Kryerja e testeve të mbylljes së vitit në fund të vitit për shitjet dhe blerjet.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

31. Departamenti i auditimit të brendshëm është caktuar për të kryer një auditim të një divizioni. Bazuar në rishikimin e dokumentacionit, auditori ka njohuri në lidhje me politikat e menaxhimit si në vijim:

- Politika e kompanisë është që të promovojë menjëherë menaxherët e divizioneve që tregojnë sukses domethënës. Si rrjedhojë, menaxherët e suksesshëm rrallë qëndrojnë në një divizion për më shumë se tre vjet.
- Një pjesë e konsiderueshme e kompensimit të menaxherëve të divizioneve vjen në formën e shpërblimeve bazuar në profitabilitetin e divizionit.

Divizioni u identifikua nga menaxhmenti i lartë si një mundësi për kthimin e investimeve. Divizioni është duke u rritur, por nuk është planifikuar për këtë vit një auditim i plotë nga auditorët e jashtëm. Divizioni është rritur me rreth 7% në vit për tre vitet e fundit dhe përdor një sistem të kostos standarde.

Gjatë auditimit të ndërmjetëm, auditori vë në dukje ndryshimet në vijim në të dhënat financiare në krahasim me vitin paraprak:

- Shitjet janë rritur me 10%.
- Kostoja e mallrave të shitura është rritur me 2%.
- Stoqet janë rritur me 15%.
- Të ardhurat neto të divizionit janë rritur me 8%.

Nëse auditori vendos se ka probleme të rëndësishme me sistemin e kostos standarde, hapi i ardhshëm i kryerjes së auditimit do të ishte:

- A. Intervistoni menaxhmentin e divizionit për të përcaktuar pse sistemi i kostos standarde nuk është azhurnuar në kohën e duhur.
- B. Zgjidh një mostër të rastësishme të produkteve dhe rishikoni ndërtimin e kostos standarde duke gjetur blerjet në regjistrin e kostos standarde.
- C. Përdorni softuer të përgjithësuar të auditimit për të përgatitur një listë të marzhës bruto sipas produktit duke krahasuar koston standarde me çmimin e shitjes. Zgjidh të gjitha artikujt me marzhë bruto të lartë për hetime të mëtejshme.
- D. Programoni të gjitha variancat dhe përcaktoni burimin dhe prirjen e tyre (dmth., a i janë alokuar stoqeve apo koston së mallrave të shitura).

32. Më poshtë janë paraqitur faktet për një filial:

- I. Kompania filiale ka qenë në biznes për disa vite dhe ka gëzuar marzha të mira fitimi edhe pse ekonomia e përgjithshme ishte në recesion, e cila i preku konkurrentët.
- II. Koeficienti i kapitalit të punës ka rënë nga një shifër e shëndetshme 3:1 në 0.9:1.
- III. Shkalla e qarkullimit të stafit, për disa vite të fundit, ka përfshirë tre kontabilistë, dy mbikëqyrës të llogarive të arkëtueshme, katër mbikëqyrës të llogarive të pagueshme dhe një numër të stafit në pozita të tjera financiare.
- IV. Politika e blerjes e korporatës kërkon tre oferta. Megjithatë, mbikëqyrësi i blerjeve në filial ka krijuar një politikë të prokurimit me burim të vetëm (me një ofertë) për të zvogëluar numrin e furnitorëve.

Gjatë kryerjes së auditimit financiar të filiales, auditori i brendshëm do të:

- A. Nuk ka gjasa të zbulojë faktin në pikën I, II ose III.
- B. Injorë faktin në pikën II pasi që ekonomia e përgjithshme kishte rënie gjatë kësaj periudhe.
- C. Konsideroj faktin në pikën III të jetë qarkullim normal i stafit, por do të jetë i shqetësuar për faktet në pikën II dhe IV si sinjale paralajmëruese të mashtrimit.
- D. Konsideroj faktet në pikën I, II, III dhe IV si sinjale paralajmëruese të mashtrimit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

33. Roni dhe Gjoni kishin njohur njëri-tjetrin për shumë vite. Ata ishin bërë miq të mirë që në kolegji, ku të dy diplomuan në kontabilitet. Pas diplomimit, Roni mori në mbikëqyrje biznesin e familjes nga babai i tij. Familja e tij kishte një biznes ushqimor për disa breza. Kur Gjoni kishte vështirësi në gjetjen e një pune, Roni i ofroi atij punë në dyqanin e familjes. Gjoni dëshmoi të qenit një punonjës shumë i aftë. Ndërsa Gjoni demonstroi aftësitë e tij, Roni filloi të delegonte gjithnjë e më shumë përgjegjësi ndaj tij. Pas një periudhe kohore, Gjoni po kryente të gjitha autorizimet dhe funksionet e përgjithshme të kontabilitetit për çeqet, paratë, stoqet, dokumentet, regjistrimet dhe harmonizimet e deklaratave bankare.

(I) Gjoni u konsiderua plotësisht i besueshëm dhe trajtoi të gjitha funksionet financiare. Askush nuk e kontrollonte punën e tij. Roni vendosi të zgjerojë biznesin dhe hapi disa dyqane të reja.

(II) Roni trajtonte gjithmonë problemet më urgjente ... profesorët e tij të kolegjit e kishin quajtur "menaxher i krizës". Gjoni e ndihmonte me problemet kur punët e tjera të tij i lejonin kohë. Ndonëse ishte i suksesshëm në punë, Gjoni kishte vështirësi me problemet financiare personale.

(III) Në fillim, shumat që Gjoni vodhi ishin të vogla. Ai as nuk u shqetësua për të bërë bilancin e llogarive. Por Gjoni u bë lakmitar. "Sa e lehtë është të marrësh para," tha ai. Ai ndjeu se ai ishte një anëtar kritik i ekipit të biznesit, dhe se ai kontribuoi shumë më shumë në suksesin e kompanisë sesa ishte përfaqësuar nga paga e tij.

(IV) Do të duheshin dy ose tre vetë për të më zëvendësuar, ai shpesh mendonte për vetveten. Ndërsa shumat bëheshin çdo herë e më të mëdha, ai bëri bilancin e librave.

(V) Për shkak të këtyre aktiviteteve, Gjoni ishte në gjendje të blente një makinë të shtrenjtë dhe të merrte familjen e tij në disa udhëtime çdo vit.

(VI) Ai gjithashtu u bashkua me një klub të shtrenjtë të vendit. Gjithsesi, gjërat ndryshonin në shtëpi. Familja e Gjoni vuri re se shpesh ai ishte argumentues dhe në raste të tjera shumë në depresion.

(VII) Mashtrimi vazhdoi për gjashtë vjet. Çdo vit biznesi performoi gjithnjë e më keq. Në vitin e kaluar dyqanet humbën mbi 200,000 €. Banka e Ronit kërkoi një auditim. Gjoni u rrëfye kur mendoi se auditorët kishin zbuluar përvetësimet e tij.

Kur diskutohen mashtrimet, shpesh janë identifikuar presionet, mundësitë dhe racionalizimet që shkaktojnë/lejojnë një keqbërës që të kryejë mashtrimin. Gjithashtu janë studiuar simptomat e mashtrimit.

Identifikoni faktorët e numëruar dhe të nënvizuar (nga skenari) si një nga simptomat, presionet, mundësitë ose racionalizimet e dhëna. **Numri III "Vështirësitë me probleme financiare personale"**, është një shembull i një:

- A. Simptome të sjelljes.
- B. Presioni të situatës.**
- C. Racionalizimi.
- D. Mundësie për të kryer.

34. Gjatë hetimit të një rritje prej 200,000€ në furnizimet e mirëmbajtjes gjatë vitit të kaluar, një agjent i blerjes i shpjegoi auditorit se arsyeja kryesore për rritjen ishin shërbimet dhe materialet e pikturimit. Auditori gjeti një urdhër blerjeje të një pëlhure pa ofertën normale ose dokumentacionin kuotues. Urdhër blerja për pëlhurën ishte nënshkruar nga menaxheri i përgjithshëm dhe babai i menaxherit të përgjithshëm ishte shënuar si kontraktori i vetëm për shërbimet e pikturimit në projektet e kompanisë. Auditori gjithashtu gjeti një numër të madh të faturave të autorizuara për pagesë nga menaxheri i përgjithshëm dhe në të cilat babai i menaxherit të përgjithshëm ishte personi që nënshkroi faturën nga ana e furnizuesit. Indikatorit i përbashkët i mashtrimeve të njohura nga auditori në këtë skenar është që:

- A. Procedurat analitike zbuluan një rritje të jashtëzakonshme në saldot e llogarive.**
- B. Ngjyrnat dhe materialet janë duke u blerë për një kontraktues.
- C. Agjenti i blerjes është duke përzgjedhur kontraktorin në baza të një urdhër blerjeje të përgjithshme.
- D. Faturat janë duke u autorizuar për pagesë nga menaxheri i përgjithshëm.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

35. Menaxhmenti i një kompanie sigurimi të pronave dhe viktimave është i shqetësuar për efikasitetin dhe efektivitetin e aktiviteteve të përpunimit të kërkesave. Menaxhmenti ka dy shqetësime kryesore: (1) Janë paguar disa kërkesa që nuk duhet të paguhen ose janë paguar në shuma që tejkalojnë politikën e kompanisë; dhe (2) shumë paditës nuk janë paguar në kohën e duhur. Në përgatitjen e një auditimi të kësaj fushe, auditori i brendshëm vendos të kryejë një studim paraprak për të mbledhur më shumë informacion rreth natyrës së përpunimit të kërkesave dhe problemeve të mundshme.

Një punonjëse e kompanisë e kontakton auditorin dhe i tregon se ajo ka informacione të rëndësishme rreth marrëveshjeve të fshehta brenda departamentit të saj për të procesuar pretendimet mashtruese dhe për të ndarë të ardhurat mes anëtarëve të një grupi të vogël. Ajo është e gatshme ta diskutojë çështjen me auditorin por dëshiron të mbetet anonime. Auditori duhet:

- A. Të kërkoj që bashkëbisedimi të filmohet në mënyrë që të jetë i disponueshëm si dëshmi për të gjetur mashtrimin.
- B. T'i përgjigjet zyrtares se çështja duhet t'i raportohet zyrtarëve të duhur të organizativës për aktivitetin ndjekës (follow-up).
- C. Të dokumentoj informacionin dhe të e përdor këtë informacion për të planifikuar auditimin. Të ndryshoj natyrën e auditimit nga ajo e ekonomisë dhe efikasitetit në atë të mashtrimeve.
- D. Të siguroj informacionin dhe të zhvilloj procedura që mund të vërtetojnë informacionin.

36. Kur një auditor i brendshëm është duke kryer intervista për të marrë informacione, auditori nuk do të jetë në gjendje të mbaj mend gjithçka që është thënë gjatë intervistës. Mënyra më efektive për të regjistruar informacionin e intervistës për përdorim të mëvonshëm është të:

- A. Shkruaj shpejt shënime, duke u përpjekur të shkruaj në detaje gjithçka ashtu siç është thënë; pastaj pas takimit hijezimi i pikave të rëndësishme.
- B. Inqizoj intervistën për të pasur gjithçka që secili ka thënë; pastaj të shkruaj gjithçka që thuhet në kompjuter për ta dokumentuar.
- C. Punësojë një asistent/e profesional për të marrë shënime, duke i lejuar përqendrim të plotë gjatë intervistës; pastaj fshirja e pikave të parëndësishme pas takimit.
- D. Organizoj shënime rreth temave në planin e intervistës dhe të shënoj përgjigjet në pika të trasha tek fusha përkatëse, duke rishikuar shënime pas takimit në mënyrë që të bëjë shënime shtesë.

37. Nëse të gjithë faktorët e tjerë të specifikuar në planin e mostrimit në bazë veçorive mbeten konstante, ulja e nivelit të konfidencës (besueshmërisë) nga 95% në 90% do të shkaktonte që madhësia e kërkuar e mostrës të:

- A. Rritet.
- B. Zvogëlohet.
- C. Ndryshoj me 5%.
- D. Mbetet e njëjtë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

38. Një auditor dëshiron të marrë dëshmi substanciale në lidhje me saldot e llogarive të arkëtueshme të divizionit. Në këtë divizion janë katër lloje të llogarive të arkëtueshme:

Lloji	Numri i llogarive	Saldo sipas librave
Shitje me pakicë	3,800	\$1,500,000
Tregtare	875	6,700,000
Agjencitë qeveritare	34	900,000
Të arkëtueshme të llojllojshme	900	375,000

Në cilin nga rastet e mëposhtme auditori do të përjashtohet nga përdorimi i konkluzioneve statistikore?

- A. Auditori zgjedh rastësisht 100 llogari të arkëtueshme tregtare për konfirmime.
- B. Auditori dërgon konfirmime për 30 nga klientët në kuadër të llojit 'llogarit e arkëtueshme të ndryshme'. Për një numër serik të euros, auditori merr dy shifrat e para që bien në mes të 1 dhe 30 për të përcaktuar pikën e fillimit dhe zgjedh çdo të tridhjeten llogari të arkëtueshme për të dërguar konfirmime.
- C. Gjatë shqyrtimit të llogarive të arkëtueshme të shitjes me pakicë, auditori vendos të konfirmojë të gjitha llogaritë e arkëtueshme me një saldo më të madhe se 2,000€. Kjo rezulton në përzgjedhjen e 87 llogarive të arkëtueshme. Auditori, duke përdorur mostrën e rastësishme të thjeshtë, zgjedh edhe 23 llogari të arkëtueshme shtesë me saldo më të vogël se 2,000€ për konfirmim.
- D. Për llogaritë e arkëtueshme me agjencitë qeveritare, auditori vendos që të mos dërgojë konfirmime, por të gjurmtojë llogaritë e arkëtueshme për arkëtimet e ardhshme të parasë. Auditori zgjedh pastaj pesë llogaritë e arkëtueshme më të mëdha dhe nga secila llogari e arkëtueshme e zgjedhur merr transaksionin e parë të blerjes, së paku 60 ditë të vjetër, për të gjurmuar për arkëtimin e ardhshëm të parasë.

39. Gjatë zgjedhjes së mostrës së artikujve për kryerjen e testimit në bazë të veçorive, auditori duhet të marrë në konsideratë faktorin e nivelit të konfidencës (besueshmërisë), saktësinë e dëshiruar dhe:

- A. Vlerën e regjistruar e valutës së popullatës.
- B. Intervalin e marrjes së mostrës.
- C. Shkallën e pritshme të ndodhjes.
- D. Devijimin standard të popullatës.

40. Gjatë përcaktimit të madhësisë së mostrës për mostrimin sipas variablave (ndryshoreve), auditori i brendshëm kërkon disa njohuri të ndryshueshmërisë së popullatës. Gjatë marrjes së këtij informacioni paraprak, auditori i brendshëm:

- A. Rrallëherë mund të mbështetet në rezultatet e mostrave të viteve të mëparshme pasi ato kanë të bëjnë vetëm me popullatën e viteve të kaluara.
- B. Herë pas here merr një mostër pilot të lehtë prej 30 deri në 50 artikuj dhe e përdor këtë për të vlerësuar ndryshueshmërinë e popullatës.
- C. Herë pas here merr një mostër piloti të rastësishëm prej 30 deri në 50 artikuj, zbaton testet e auditimit për këto artikuj dhe përdor ndryshueshmërinë në këto artikuj për të vlerësuar ndryshueshmërinë në popullatën e vlerave të auditimit. Mostra pilot pastaj hiqet dhe mostra e vërtetë merret nga popullata e mbetur.
- D. Herë pas here merr një mostër piloti të rastësishëm prej 30 deri në 50 artikuj, llogarit vargun në këtë mostër dhe e përdor këtë varg si një vlerësim të ndryshueshmërisë së popullatës për qëllime të llogaritjes së madhësisë së mostrës.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

41. Një auditor po planifikon të përdorë mostrën e njësive monetare për të testuar vlerën e dollarit të një popullate të madhe të llogarive të arkëtueshme. Përparësitë e përdorimit të mostrave të njësive monetare përfshijnë të gjitha këto, përveç që:

- A. Është model efikas për të vërtetuar se një popullatë e shkallës së ulët të gabimit nuk ka anomali materiale.
- B. Nuk kërkohet përafrim normal i shpërndarjes i kërkuar nga mostrimi sipas variablave (ndryshoreve).
- C. Mund të aplikohet për një grup të llogarive, pasi që njësitë e mostrimit janë homogjene.
- D. Rezulton në një madhësi më të vogël të mostrës sesa ajo që kërkohet me rritjen e gabimeve kur përdoret mostrimi klasik.

42. Modulet e inkorporuara të auditimit:

- A. Identifikojnë kodin kompjuterit të pazbatuar.
- B. Ndhimojnë gjatë procesit të gjetjes së gabimeve në sistemet e aplikimit.
- C. Analizojnë efikasitetin e programimit.
- D. Mundësojnë monitorimin e vazhdueshëm të përpunimit të transaksioneve.

43. Cili nga elementet e mëposhtme, është burimi më efikas që mund të përdorë një auditor për të vlerësuar sistemin e përgjithshëm të kontrollit të kompanisë?

- A. Skemat e rrjedhjes së punës kontrollit.
- B. Kopjet e procedurave standarde të operacioneve.
- C. Një tregim që përshkruan historinë e departamentit, aktivitetet, dhe formularët e përdorur.
- D. Kopjet e standardeve operacionale të industrisë.

44. Gjatë dokumentimit të procedurave të përdorura nga disa departamente që bashkëveprojnë me njëri tjetrin, auditori i brendshëm me mundësi të madhe do të përdorë:

- A. Një skemë horizontale të rrjedhjes së punës.
- B. Një skemë vertikale të rrjedhjes së punës.
- C. Një grafik Gantt.
- D. Një pyetësor mbi kontrollet e brendshme.

45. Një auditor po teston mbi një kartelë të madhe të llogarive të arkëtueshme të një kompanie. Objektivat e auditimit janë të testojnë saldot në euro në fund të periudhës dhe normat e përjashtimit (gabimit) të regjistrimeve të të arkëtueshmeve. Konto e llogarive të arkëtueshme përmban një numër të madh të saldove të shumave të vogla në euro dhe një numër të vogël të saldove në shuma të mëdha në euro dhe auditori pret të gjejë gabime të shumta në saldot e llogarive. Teknika më e përshtatshme e përzgjedhjes së mostrave për të vlerësuar sasinë e gabimeve në euro do të ishte:

- A. Diferenca ose vlerësimi i koeficientëve.
- B. Diferenca e pabazuar për njësi.
- C. Probabiliteti proporcional me madhësinë.
- D. Veçoria.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

46. Cila nga këto është një faktor thelbësor në vlerësimin e mjaftueshmërisë së dëshmisë? Dëshmia duhet:

- A. Të jetë e dokumentuar mirë dhe të referohet tërësisht në dokumentet e punës.
- B. Të bazohet në referenca që konsiderohen të besueshme.
- C. Të ketë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me gjetjen dhe të përfshij të gjitha elementet e gjetjes.
- D. Jetë mjaft bindëse që një person i kujdesshëm të arrij në të njëjtin vendim.

47. Gjatë një auditimi, auditori i brendshëm duhet të marrë në konsideratë faktorin (faktorët) e mëposhtëm në përcaktimin e shkallës deri tek e cila duhet të përdoren procedurat analitike:

- A. Përshtatshmëria e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- B. Rëndësia e fushës që po kontrollohet.
- C. Saktësia me të cilën mund të parashikohen rezultatet e procedurave analitike të auditimit.
- D. Të gjitha të mësipërmet.

48. Cila nga format e mëposhtme të dëshmisë paraqet dëshminë më kompetente se një llogari e arkëtueshme ekziston faktikisht?

- A. Një konfirmim pozitiv.
- B. Një faturë e shitjes.
- C. Një raport pranimi.
- D. Një faturë e ngarkesës.

49. Cila nga të mëposhtmet nuk mund të përdoret për të kundërshtuar një instrument me shkrim?

- A. Evidencat gojore.
- B. Evidenca e dokumentuar.
- C. Evidenca rrethimore.
- D. Evidenca vërtetuese.

50. Cila nga evidencat e mëposhtme nuk ka nevojë për vërtetim?

- A. Evidenca prej opinioneve.
- B. Evidenca konkluduese.
- C. Evidencat thashetheme.
- D. Evidenca rrethimore.

Fletë për ushtrime – mos i paraqitni zgjidhjet këtu!

